

## TËRMETI, BONUSI I QERAVE

Në bashkinë Vorë, ashtu sikundër edhe në zonat e tjera të prekura nga tërmeti, familjet banesat e të cilëve janë klasifikuar të pabanueshme për shkak të dëmtimeve nga lëkundjet e tërmetit, kanë përfituar bonusin e qerasë. Kryeministri Rama dhe ministrja Balluku vizituan një prej këtyre familjeve, e cila me bonuesin e përfituar tashmë është akomoduar në një banesë të marrë me qera. Në bashkinë Vorë janë shpërndarë deri më tani 650 bonuse qeraje.

## DIXHITALIZIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Që prej 1 janarit 2020, MIE dhe institucionet e varësisë ofrojnë 50 shërbime online për qytetarët duke u kursyer kohë atyre kohë dhe duke evituar mundësitë për korrupsion. Në 10 ditët e para të ofrimit të këtyre shërbimeve, 150 qytetarë kanë aplikuar online përmes platformës qeveritare e-Albania, duke marrë edhe zgjidhjet përkatëse. 42 shërbime të tjera do të ofrohen online deri në datën 30 qershor ndërsa deri në fund të 2020 numri i tyre do të arrijnë në 162 shërbime.

## SIGURIA RRUGORE

Në një tryezë me përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Policia e Shtetit, të zgjedhur vendorë dhe ekspertë të fushës, u diskutua mbi masat që duhen marrë për të rritur sigurinë rrugore në vend dhe reduktuar numrin e aksidenteve rrugore. Për këtë qëllimin, ndërhyrja për eliminimin e pikave të zeza dhe ngritja e Qendrës së Menaxhimit të Trafikut do të jenë në fokus të punës së MIE dhe ARRSH gjatë vitit 2020.

## BASHKËPUNIMI RAJONAL

Ministrja Belinda Balluku mori pjesë në konferencën XVI të komisioneve parlamentare për integrimin evropian të shteteve pjesëmarrëse në procesin e stabilizimit dhe asociimit të Evropës Juglindore. Në fjalën e saj ministrja Balluku evidentoi disa prej projekteve të përbashkëta rajonale në infrastrukturë dhe energjetikë dhe theksoi rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor.

## LAÇ, INVESTIMI I OSHEE

Investimi për rikonstruksionin e linjës në tensionin e mesëm 6kV do përmirësojë furnizimin me energji për 850 abonentë në fshatrat Zhejëm, Gjormë, Fushë-Gjormë, Vilëz, Shëmri të Laçit. OSHEE ka nisur një tjetër investim në autostradën Mamurras - Fushë Milot, i cili përfshin ndërtimin e linjave kabllore TM, kabina të reja dhe linja TU me kabëll ABC.

## KESH, BASHKËBISEDIM ME STUDENTËT

U zhvillua një tryezë diskutimi me studentët e ciklit Master i Shkencave në Energjitë e Rinovueshme, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, gjatë së cilës studentët u njohën me zhvillimet e fundit në sektorin energjetik dhe iniciativën e KESH për diversifikimin e burimeve gjeneruese të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.